

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
MISIONI, VIZIONI, VLERAT	7
SHKURTESAT E PËRDORURA	8
SHTYLLAT STRATEGJIKE	9
SHTYLLA I: KRIJIMI I BESIMIT DHE VETËBESIMIT	11
SHTYLLA II: AVANCIMI I ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË	17
SHTYLLA III: SHITIMI I QASJES NË DREJTËSI DHE NË SHËRBIMIN PËR QYTETARË	21
SHTYLLA IV: PROMOVIMI I KOMPETENCËS, PROFESIONALIZMIT DHE MIRËSJELLJES	25
SHTYLLA V: PËRMIRËSIMI I OBJEKTEVE DHE TEKNOLOGJISË SË GJYKATAVE	29
ZBATIMI DHE MONITORIMI I PLANIT STRATEGJIK	31
SHTOJCA 1 ANËTARËT E KOMISIONIT PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK	33
SHTOJCA 2 AKTIVITETET, PËRGJEGJËSITË DHE TREGUESIT PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	35

HYRJE

Plani i parë strategjik për gjyqësorin e Kosovës është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i cili është formuar para pak kohësh, më 16 prill të vitit 2007, për periudhën 2007-2012. Në atë kohë, ligjet kryesore, siç janë Ligji për Gjykatat dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, ende nuk ishin miratuar. Plani i parë i ka pasur 8 qëllime. Disa nga to, siç ishte qëllimi 1 – *Të krijohet një kornizë ligjore dhe administrative e shëndoshë për organizimin dhe punën e gjykatave*, janë realizuar përmes një sistemi gjyqësor të ri që tashmë i ka mbushur një vit. Disa të tjera, siç është qëllimi 5 – *Të eliminoheshin lëndët e vjetra të grumbulluara dhe të sigurohet zgjidhja me kohë e të gjitha lëndëve që u ishin dorëzuar gjykatave*, ende nuk janë realizuar dhe paraqiten përsëri në këtë plan. Fakti se jo çdo qëllim është arritur nuk është i pazakonshëm. Por, qëllimet që janë realizuar janë realizuar pa iu referuar edhe aq shumë planit strategjik. Me fjalë të tjera, plani strategjik është miratuar, e pastaj është shpërfillur shumë. Pa dyshim se nuk është përdorur si mjet për menaxhim. Nuk janë bërë rishikime rutinore për ta vërtetuar përparimin e bërë drejt secilit qëllim.

Këshilli synon që ky Plan Strategjik të mos e ketë fatin e njëjtë. Qëllimi i këtij Plani Strategjik është që të jetë mjet për menaxhim të përditshëm. Pritet që të shërbejë si udhëzues për ta udhëzuar gjyqësorin e Kosovës që të arrijë nga ku është sot atje ku aspiron të jetë gjatë pesë viteve të ardhshme. Për këtë qëllim, Këshilli ka nxitur në mënyrë aktive çdo sektor të sistemit gjyqësor që ta ofrojë kontributin e tij. Në anën tjetër, Sekretariati është zotuar se do ta angazhojë një person për ta monitoruar përparimin e bërë drejt secilit objektiv strategjik që e përmban ky Plan. Planet e veprimit për secilin objektiv janë hartuar gjatë procesit të hartimit të këtij Plani dhe do të shtjellohen me kalimin e kohës. Po ashtu, për secilin objektiv është përcaktuar afat.

Plani Strategjik është prezantuar në Këshill dhe është aprovuar në prill 2014. Do të realizohet prej qershorit 2014 deri në qershor 2019. Ka për qëllim që të jetë dokument i gjallë; planet punuese për secilën objektivë strategjike, dhe vetë objektivat strategjike do të përshtaten me kalimin e kohës ashtu si është e domosdoshme për të zbatuar qëllimet dhe shtyllat e planit.

Edhe pse obligimi ligjor për ta miratuar një plan strategjik parashihet me nenin 34 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe se në këtë nen përmendet plani strategjik i Këshillit, ne kemi vendosur që këtë dokument ta quajmë **“Plani Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës”**. Arsyeja për këtë emërtim gjithëpërfshirës është se Këshilli nuk ekziston në vakum. Kompetencat dhe përgjegjësitë e tij janë të shumta dhe përfshijnë 27 paragrafë të tjerë në kuadër të nenit 4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Disa nga këta paragrafë kanë të bëjnë me Këshillin, disa kanë të bëjnë me Sekretariatit, ndërsa disa me vetë gjykatat. Për këtë arsye, një plan strategjik duhet të merret me aspektet e çdo subjekti të tillë. Pastaj, nëse ky Plan do të jetë udhëzues që ndiqet dhe zbatohet, secila pjesë e gjyqësorit – Këshilli, Sekretariati dhe gjykatat – duhet t’i marrin përsipër përgjegjësitë unike të tyre.

Për këtë arsye, për ta hartuar këtë plan është caktuar një komision, i cili është përbërë nga anëtarë të Këshillit, përfshirë kryesuesin, anëtarët e Sekretariatit, përfshirë drejtorin, dhe

përfaqësuesit e gjykatave, përfshirë gjyqtarët, profesionistët ligjorë dhe personelin administrativ të gjykatave, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe këshilltarët ndërkombëtarë nga EROL-i, EULEX-i dhe projekteve të IPA të ZBEK.

Ky proces ka filluar me një vlerësim dyditor të nevojave të tanishme dhe të parashikueshme. Pas kësaj, në një varg takimesh janë qartësuar dhe rafinuar nevojat që janë identifikuar. Një grupi punues të vogël nga ky komision i është caktuar për detyrë që t'i kthejë nevojat në objektiva strategjike. Ky grup punues i vogël e ka përpiluar një tabelë, e cila përmban "shtylla", të cilat përfaqësojnë vlerat dhe vizionin. Nën secilën shtyllë janë përcaktuar objektiva strategjike duke u bazuar në nevojat që janë identifikuar më parë, ndërsa për secilin objektiv është caktuar një afat– afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë– janë caktuar përgjegjësitë e individëve apo grupeve për përparim dhe janë caktuar pikat dhe afatet kohore për veprim. Tabela do të përdoret për të hartuar plane të punës më specifike për secilin objektiv strategjik.

Për ta përmbledhur, ky Plan Strategjik është produkt i kontributit entuziast të të gjithë sektorëve të sistemit gjyqësor dhe paraqet mjet shumë të nevojshëm dhe të dobishëm për menaxhimin strategjik të gjyqësorit të Kosovës. Këshilli është krenar që e miraton atë.

MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT

MISIONI: Të krijohet dhe ruhet një sistem gjyqësor kosovar i pavarur që u ofron shërbime gjyqësore të paanshme të gjithëve dhe që është funksional në të gjitha aspektet organizative dhe operative.

VIZIONI: Një sistem gjyqësor kosovar që është i pavarur, i qasshëm për të gjithë, i drejtë dhe efikas në punën e tij, që jep llogari për punën e vet, që është funksional dhe që u përmbahet standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, kompetencës, profesionalizmit dhe transparencës.

VLERAT E GJYQËSORIT: Obligimi themelor i gjykatave është që kontestet t'i zgjidhin në mënyrë të drejtë, me kohë dhe në pajtim me ligjin e zbatueshëm. Gjersa i përmbush obligimet e tij dhe i shërben popullit të Kosovës, sistemi gjyqësor do t'u përmbahet vlerave themelore si vijon:

- pavarësisë gjyqësore
- vendimmarrjes së drejtë dhe të paanshme
- kompetencës, profesionalizmit dhe mirësjelljes
- qasjes dhe trajtimit të barabartë për të gjithë
- sinqeritetit dhe integritetit në marrëdhëniet e tij me të tjerët
- transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut
- efikasitetit dhe efektivitetit

SUPOZIMET

- Financimi adekuat nga QK-ja
- Financimi i plotë nga Mbretëria e Norvegjisë për zhvillimin e SMIL-it
- Resurset njerëzore të mjaftueshme dhe të afta
- Mjedisi politik dhe ekonomik stabil.

SHKURTESAT

BE-Bashkimi Evropian

CLE-Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial /Projekt i USAID-it

EROL-Programi për sundimin efektiv të ligjit/ Projekt i USAID-it

EULEX-Misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë

IGJK-Instituti Gjyqësor i Kosovës

IPA- Instrumente të Para-aderimit

KGJK –Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK- Këshilli Prokurorial i Kosovës

MAP-Ministria e Administratës Publike

MD-Ministria e Drejtësisë

MiM-Memorandum i Mirëkuptimit

QK-Qeveria e Kosovës

SKGJK-Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

SKRLV-Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra

SMIL- Sistemi i menaxhimit informative të lëndëve

TIK-Teknologjia Informative e Komunikimit

ZBEK-Zyra e BE-së në Kosovë

SHTYLLAT STRATEGJIKE

Pesë shtyllat strategjike që e përbëjnë këtë Plan paraqesin, gjerësisht, aspiratat e komunitetit gjyqësor të Kosovës. Qëllime specifike për jetësimin e aspiratave të shtyllave janë caktuar brenda çdo shtylle. Për secilin qëllim janë përcaktuar objektiva strategjike konkrete, për t'u siguruar që secili qëllim të arrihet. Secili objektiv strategjik përmban një pasqyrë të përgjithshme të planit të veprimit për ta realizuar atë. Qëllimi i hartuesve të këtij dokumenti ka qenë që në këtë Plan të jepen detaje të mjaftueshme për ta mundësuar monitorimin e jashtëm të përparimit drejt secilit qëllim. Në këtë Plan po ashtu pranohet se do të nevojitet një plan i veprimit më i hollësishëm – si bazë për të cilin do të merret plani i përgjithshëm të cilin e përmban ky dokument, së bashku me tabelën në shtojcën 2 –për ta arritur çdo qëllim që e përmban ky Plan.

SHTYLLA I

Krijimi i besimit dhe mbështetjes

Besimi dhe mbështetja në sistemin gjyqësor janë esenciale për ruajtjen e një shoqërie demokratike të rregullt dhe të pavarësisë gjyqësore. Gjyqësori i Kosovës duhet të perceptohet si i drejtë, i paanshëm dhe i pavarur në vënien e drejtësisë dhe zgjidhjen e kontesteve. Si institucion publik, sistemi gjyqësor duhet të jap llogari për veprimet dhe vendimet e tij.

Qëllimi 1.1

Të forcohen mekanizmat institucionalë ndaj ndërhyrjeve të jashtme.

Objektivi strategjik 1.1.1

Gjyqësori duhet të jetë i pavarur financiarisht.

Tani buxhetin për gjyqësorin e siguron Ministria e Financave. Për t'u siguruar që gjyqësori të marrë buxhet adekuat nga Kuvendi, KGjK-ja dëshiron të shohë ndryshime në ligj, për të mundësuar që buxheti që ai e propozon për gjyqësorin t'i dorëzohet Kuvendit drejtpërsëdrejti. KGjK-ja e kupton se propozimet për ndryshimin e ligjit duhet t'ia dorëzojë MD-së, e cila është subjekti që i harton projektligjet apo propozim-amendamentet në sektorin e drejtësisë për t'iu dorëzuar Kuvendit. KGjK-ja do të punojë në përgatitjen e një dokumenti ideor, në të cilin do të jepen arsyet për nevojën për ndryshime në ligj, për t'ia ofruar MD-së, ndërsa arsyet për një ndryshim në ligj do të jepen edhe në raportin vjetor të saj për Kuvend. KGjK-ja do t'i përdorë mekanizmat e njëjtë për t'u siguruar që degës ekzekutive të mos i lejohet të nxjerr udhëzime administrative që do të kishin implikime financiare negative për gjyqësorin pa aprovimin e KGjK-së.

Objektivi strategjik 1.1.2

KGjK Këshilli – procesi i emërimit, përbërja dhe statusi duhet të ndryshohen.

12

Sipas nenit 108.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, KGjK-ja duhet t'i ketë 13 anëtarë, 8 nga të cilët do të zgjidhen nga Kuvendi. Fakti se 8 nga 13 anëtarët emërohen nga Kuvendi shkakton brengën se agjendat politike mund ta pengojnë punën e pavarur të KGjK-së. Arsye tjetër për shqetësim përbën fakti se KGjK-ja ka funksionuar qe pothuaj dy vjet pa u plotësuar dy nga vendet që i janë rezervuar Kuvendit. Kjo shkakton vështirësi operative, meqë ka më pak anëtarë të Këshillit për t'i marrë përsipër detyrat, siç janë ato të kryesuesve të komisioneve, ndërsa është vështirë që të sigurohet kuorumi (prej nëntë anëtarësh) për anëtarët e këshillit. Meqë çështjet që i parashtrihen Këshillit ndikojnë vetëm në gjyqësor, KGjK-ja dëshiron ta ketë fuqinë që të emërojë më shumë anëtarë të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve dhe që të ketë ligje më të përshtatshme për ta siguruar diversitetin gjinor dhe etnik. KGjK-ja propozon që të studiohet çështja se a duhet të përfshihen persona nga jashtë gjyqësorit, siç janë nga shoqëria civile, apo jo. Si në rastin e objektivit strategjik 1.1.1, KGjK-ja do ta ndjekë një procedurë për ta gjetur një propozim për ndryshime në ligj dhe në Kushtetutë, për t'i dhënë MD-së sugjerime për ndryshimin e ligjit dhe të Kushtetutës dhe për t'i përshirë arsyet pse ka nevojë për ndryshime në raportin vjetor të tij për Kuvend.

Objektivi strategjik 1.1.3

Mandati i gjyqtarëve duhet të bëhet i përhershëm.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, KGjK-ja ia rekomandon Presidentit gjyqtarët për emërim për një mandat fillestar trevjeçar. Ata vlerësohen në fund të këtij mandati dhe, nëse kanë bërë mjaft përparim në përgjegjësitë gjyqësore të tyre, rekomandohen për mandate gjyqësore të përhershëm. Ky proces, që përfshin një periudhë fillestare provuese, nuk ndiqet

nga disa shtete anëtare të BE-së dhe ia shton procesit edhe një shtresë nëpër të cilën duhet të kalojë KGJK-ja. Deri më tani, pothuaj të gjithë gjyqtarët e rinj që kanë kaluar nëpër periudhën fillestare trevjeçare janë rekomanduar për mandat të përhershëm. Me procese disiplinore të përforcuara, do të kishte mjaft mjete juridike mbrojtëse për t'i hequr qafe ata që nganjëherë nuk e kryejnë punën e tyre si duhet. Departamenti ligjor i SKGJK-së do ta përgatisë një dokument ideor të hulumtuar në mënyrë të thukët në të cilin do të demonstrohet nevoja për një rishikim të Kushtetutës dhe të ligjit. KGJK-ja do t'i nisë përpjekjet me MD-në, në mënyrë që MD-ja t'ia propozojë Kuvendit ndryshimet që duhet të bëhen në ligj. KGJK-ja do t'i paraqesë arsyet për ndryshim edhe në raportet vjetore të tij për Kuvend.

Objektivi strategjik 1.1.4

Imuniteti i gjyqtarëve për vendimet që merren gjatë kryerjes së detyrave të tyre duhet të mbrohet.

Edhe pse Kushtetua e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Gjykatat e garantojnë imunitetin e gjyqtarëve kundër ndjekjes apo padive për vendimet që i marrin gjatë kryerjes së detyrave të tyre, qytetarët vazhdojnë t'u ankohen prokurorëve për vendimet e pafavorshme, ndërsa disa prokurorë vazhdojnë të ngrisin padi kundër gjyqtarëve. KGJK-ja ka monitoruar dhe do të vazhdojë ta monitorojë situatën dhe nëse prokurorët vazhdojnë të ngrisin padi, nga KPK-ja do të kërkohen udhëzime të mëtejme për ta përmirësuar situatën.

Objektivi strategjik 1.1.5

Ndryshimi i statusit të personelit të gjykatës dhe KGJK-së nga shërbyesit civilë në nëpunës gjyqësorë duhet të bëhet.

Tani shumica e stafit administrativ të gjykatave dhe të Sekretariatit janë shërbyes civilë. Kjo do të thotë se kryetarët e gjykatave dhe menaxherët e Sekretariatit kanë kontroll të kufizuar mbi të punësuarit që u raportojnë atyre për çështjet siç janë disiplinimi dhe pagat. Përveç kësaj, fakti që personeli kyç i gjyqësorit udhëhiqet nga rregullat e pushtetit ekzekutiv të qeverisë krijon çështje serioze që i përkasin ndarjes së pushteteve në mesin e tri shtyllave të qeverisjes, e që paraqet rrezik për pavarësinë e gjyqësorit. KGJK-ja dëshiron që ligji të ndryshohet, në mënyrë që personeli i gjykatave dhe i Sekretariatit të jenë në një kategori të veçantë dhe të mos u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve për shërbimin civil. Kjo do të ndikojë në funksionimin më të mirë të gjykatave dhe të Sekretariatit. KGJK-ja propozon që të hartohet një dokument ideor, në të cilin duhet të identifikohet nevoja për pavarësi nga shërbimi civil si dhe të fillohen diskutimet me MD-në për t'i hartuar amendamentet për ligje për ta bërë këtë ndryshim. KGJK-ja po ashtu do të japë argumente bindëse për ndryshimet e propozuara në raportet vjetore të tij për Kuvend.

Objektivi strategjik 1.1.6

Duhet të hartohen procedura për t'i përforcuar marrëdhëniet gjyqësor-media.

Mediat janë portal përmes së cilit shumica e qytetarëve të Kosovës mësojnë për atë që ndodhë brenda sistemit gjyqësor. Prandaj, është esenciale që informacioni që e marrin mediat për rastet që gjykohen në gjykata dhe për funksionimin e KGJK-së dhe të gjykatave të jetë i saktë dhe të ofrohet në kohën e duhur. Ngjashëm, është me rëndësi që mediat t'i kuptojnë procedurat ligjore dhe të dinë për çfarë informacioni mund të raportohet dhe çfarë informatash nuk mund të

ofrohen për shkak të ligjeve për privatësinë dhe me qëllim të mbrojtjes së dëshmitarëve të ndjeshëm. Zyrtarët për informim publik tani janë punësuar në pothuajse çdo gjykatë. Me trajnim të duhur, ata do të shërbejnë si lidhje efektive midis gjykatave, KGjK-së dhe qytetarëve të Kosovës. Përveç kësaj, strategjia e komunikimit për gjyqësorin është përpiluar dhe duhet të paraqitet në Këshill për aprovim në mënyrë që të ketë rregulla të njëtrajshme në gjithë sistemin gjyqësor për të përcjellë rrjedhën e informacionit në publik dhe media.

Objektivi strategjik 1.1.7

KGjK-ja duhet t'i bashkërendojë veprimet dhe aktivitetet e saj me subjektet jo-gjyqësore, siç janë MD-ja dhe Oda e Avokatëve, të cilat kanë ndikim në sistemin gjyqësor.

Shumë shpesh sot merren vendime dhe hartohen ligje që ndikojnë në sistemin e drejtësisë pa u koordinuar me institucionet e tjera në sektorin e drejtësisë. Kjo mungesë e mekanizmave institucionalë për të siguruar që të gjithë vendimmarrësit të jenë të ndërgjegjshëm për qëndrimet e të tjerëve çon në humbje të burimeve të pakta, ndërsa miratimi i ligjeve dhe rregulloreve nuk është harmonizuar në mënyrë adekuate. KGjK-ja do të hartojë procedura dhe mekanizma të komunikimit rutinor, për t'u siguruar mjete institucioneve të ndryshme brenda sistemit të drejtësisë për të komunikuar, për t'iu shmangur keqkuptimeve dhe për t'i harmonizuar përpjekjet e tyre.

Qëllimi 1.2

Forcimi i mekanizmave të vlerësimit dhe atyre disiplinorë.

14

Objektivi strategjik 1.2.1

Vlerësimi i gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor duhet të forcohet që të jetë më objektiv, i paanshëm dhe i drejtë, me sanksione të përshtatshme për gjyqtarët që janë nën nivelin e detyrave të tyre.

KGjK-ja e ka miratuar një rregullore për vlerësimin e gjyqtarëve. Megjithatë, me të nuk parashihet disiplinimi i gjyqtarëve me performancë të ulët. Ndryshimet në këtë rregullore dhe aktet tjera nënligjore, mund të jenë të domosdoshme për të siguruar që rrimërimet, transferimet dhe ngritjet në pozita të mbështeten në vlerësime. Këto informata për gjyqtarë do të futen në një bazë të veçantë të të dhënave për të gjithë gjyqtarët.

Objektivi strategjik 1.2.2

Sistemi disiplinor për gjyqtarët dhe të tjerët në sistemin gjyqësor duhet të përforcohet, ndërsa vendimet duhet të bëhen publike.

Një nga ankesat më të mëdha kundër sistemit gjyqësor është se gjyqtarëve që e shkelin ligjin nuk u shqiptohen masa disiplinore të duhura, ndërsa informatat për disiplinimin gjyqësor nuk bëhen publike. KGjK-ja do ta rregullojë këtë situatë, duke e ngritur cilësinë dhe numrin e burimeve njerëzore në Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe duke ia siguruar kësaj zyre një sistem të automatizuar të menaxhimit të lëndëve. KGjK-ja do të drejtojë një studim të dënimeve, për

të vlerësuar nëse po shqiptohen në mënyrë të njëtrajtshme. Do të miratohet një rregullore që do ta rregullojë funksionimin e komisionit disiplinor të Këshillit. Anëtarët e komisionit do të kenë trajnime në analizim ligjor dhe shkrim të vendimeve. Do të përcaktohen rregulla të duhura për qasjen publike dhe për raportimin e vendimeve disiplinore.

SHTYLLA II

Avancimi i administrimit të drejtësisë

Procedurat e drejta dhe me kohë dhe informatat e sakta dhe të plota janë esenciale për zgjidhjen e drejtë të kontesteve. Ngarkesat e ndërlikuara dhe të mundimshme në punë dhe nevojat për një komunitet të ndryshëm kërkojnë që gjykatat e Kosovës ta bashkërendojnë përdorimin e resurseve të sistemit të drejtësisë në mënyrë efikase dhe efektive.

Qëllimi 2.1

Procesi i avancuar i buxhetimit.

Objektivi strategjik 2.1.1

Buxhetimi duhet të bëhet duke u bazuar në treguesit e performancës.

Buxhetimi aktualisht bazohet në buxhetin e fundit. Gjykatat dhe KGjK-ja tani kanë të dhëna statistikore të besueshme që identifikojnë mjaft të dhëna për lëndët e vjetra, lëndët aktuale dhe lëndët e reja të parashtruara. Me këto të dhëna, gjykatat do të jenë në gjendje të kuptojnë se çfarë ju duhet atyre për t'u marrë si duhet me lëndët e grumbulluara dhe me buxhetin. Trajnime do t'i ofrohen personelit të gjykatave për buxhet dhe SKGjK-së, për të siguruar që buxhetimi të bazohet në shkathtësitë themelore dhe në performancë.

Qëllimi 2.2

Menaxhimi më i mirë i burimeve njerëzore.

Objektivi strategjik 2.2.1

KGjK-ja duhet të jetë në gjendje ta vlerësojë numrin e gjyqtarët që i duhen dhe t'i caktojë ata sipas një procesi të një planifikimi objektiv.

Për herë të parë, KGjK-ja ka qenë në gjendje të shpallë konkurse për vende të lira të punës duke u bazuar në statistikën nga baza e të dhënave të tij. Ky proces do të bëhet më i sofistikuar kur KGjK-ja do ta zhvillojë një analizë të lëndëve sipas rëndësisë së tyre. Procedura duhet të zbatohet për ta rregulluar këtë proces. Këto procedura po ashtu do t'ia mundësojnë KGjK-së që t'i shpërndajë gjyqtarët në mënyrë më efektive.

Qëllimi 2.3

Miratimi i akteve nënligjore dhe politikave të duhura për një sistem gjyqësor efikas.

Objektivi strategjik 2.3.1

KGjK-ja duhet të miratojë procedura për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe akteve nënligjore të tjera.

Tani ekzistojnë rregullore brenda degës ekzekutive të qeverisë për ta siguruar një procedurë uniforme për miratimin e akteve nënligjore. Me këto rregullore kërkohet, mes tjerash, një periudhë për publikimin e akteve të propozuara dhe për kërkimin e komenteve. Miratimi i procedurave të ngjashme brenda sektorit gjyqësor do ta mundësojë miratimin e akteve nënligjore të arsyetuara më mirë dhe më uniforme.

Qëllimi 2.4

Ndërtimi i mekanizmave të menaxhimit për llogaridhënie gjyqësore.

Objektivi strategjik 2.4.1

Lëndët e grumbulluara në sistemin gjyqësor duhet të eliminohen dhe duhet të miratohen procedura për t'iu shmangur grumbullimit të lëndëve në të ardhmen.

Një numër i madh i lëndëve të grumbulluara ka ekzistuar qysh kur sistemi gjyqësor është organizuar për republikën e re të Kosovës. Përpjekjet që janë bërë për ta zgjidhur çështjen e lëndëve të grumbulluara sipas strategjisë së parë për reduktimin e lëndëve të vjetra nuk kanë qenë të kënaqshme. KGJK-ja e ka miratuar strategjinë të dytë kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra, e cila inkorporohet përmes kësaj reference. Mjetet kryesore tani ekzistojnë në formë të të dhënave të një baze të të dhënave të besueshme, e cila, me planet që po hartohen tani në çdo gjykatë themelore, do të sigurojë proces gjithëpërfshirës me përgjegjësi lokale dhe monitorim nga Sekretariati, për ta reduktuar numrin e lëndëve të vjetra. Një fokus i veçantë i planeve në secilën gjykatë do të jetë tek reduktimi i lëndëve të përmbarimit përmes metodave më efikase të marrjes me këto lëndë. Tani ekzistojnë mjete shitesë për t'i bartur gjyqtarët aty ku më së shumti ka nevojë.

Objektivi strategjik 2.4.2

Duhet të krijohen dhe zbatohen procedura dhe mekanizma për ta nxitur llogaridhënien individuale në tërë sistemin gjyqësor.

Me mundësinë e tanishme për të pasur të dhëna statistikore duke u bazuar në bazën e të dhënave të lëndëve, është e mundur që të vlerësohen dhe krahasohen të dhënat, siç janë rastet që janë zgjidhur gjatë një periudhe të caktuar. Me shabllonet për raportim, ashtu që raportet rutinore të mund të krahasohen, do të vjen një mënyrë më e lehtë për ta siguruar llogaridhënien dhe për t'i korrigjuar situatat në të cilat personeli apo gjyqtarët nuk duket se i arrijnë rezultatet e pritshme.

Qëllimi 2.5

Rishikimet në strukturën organizative të Sekretariatit.

Objektivi strategjik 2.5.1

SKGJK-ja duhet t'i ofrojë mbështetje më të mirë Këshillit.

Këshilli duhet të bëhet organ politikëbërës, ndërsa pjesa me e madhe e punëve të përditshme të kryhen nga Sekretariati, e në veçanti nga një departament ligjor i fuqishëm. Ky departament duhet jo vetëm t'u ofrojë ndihmë administrative të gjitha komisioneve të Këshillit, por edhe ta marrë nismën për punët e përditshme të komisioneve. Për shembull, departamenti ligjor duhet ta zhvillojë një agjendë të prioritetizuar për Komisionin Normativ për aktet ligjore që i duhet t'i marrë në konsideratë dhe t'i përgatisë dokumentet e hartuara mirë për përsëritje të parë dhe për shqyrtim nga ana e Komisionit. Departamenti ligjor duhet të përfitojë nga hulumtimet nga vendet dhe organizatat e tjera.

Objektivi strategjik 2.5.2

SKGjK-ja duhet të ketë një departament ose njësi për hulumtim dhe hartim të praktikave më të mira të administratës gjyqësore.

Sekretariati nuk do të jetë në gjendje t'i japë mbështetje optimale Këshillit, komisioneve të tij dhe gjykatave pa qasje në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe në modelet e administratës gjyqësore të vendeve të tjera për krahasim. Për këtë detyrë, atij do t'i duhen burimeve njerëzore në formën të studiuesve dhe analistëve ligjorë të kualifikuar për hulumtime të brendshme dhe të jashtme dhe qasje në bazat specifike të të dhënave të bazuara në internet.

Objektivi strategjik 2.5.3

Niveli i koordinimit midis dhe brenda KGjK-së, SKGjK-së dhe gjykatave duhet të përmirësohet.

Përderisa sekretariati e definon dhe i jep trajtë vetvetes për t'i ofruar mbështetje optimale Këshillit dhe gjykatave, ai duhet t'i gjejë mënyrat për t'u koordinuar dhe për të komunikuar në mënyrë më efektive me personelin kyç brenda sistemi gjyqësor. Sistemet efektive të shërbimeve të postës elektronike dhe intranetit do të jenë kyçe, ndërsa i tërë personeli duhet të trajnohet për përdorimin e tyre. Koordinimi i aktiviteteve përmes takimeve dhe raporteve e protokolleve rutinore do të ndihmojë që të gjithë të jenë të informuar rregullisht për çështjet kyçe.

Qëllimi 2.6

Bartja e përgjegjësi të administratës dhe personelit nga Sekretariati tek gjykatat.

20

Objektivi strategjik 2.6.1

SKGjK-ja duhet t'i bartë kompetencat më të përshtatshme menaxheriale dhe administrative tek gjykatat individuale dhe ta rishikojë strukturën e tij të brendshme sipas rrethanave.

Pjesë e rëndësishme e transformimit të Sekretariatit në një organizatë mbështetëse efektive për gjykatat dhe Këshillin do të jetë delegimi i disa detyrave dhe përgjegjësi nga Sekretariati tek gjykatat themelore individuale. Për këtë do të kërkohet një studim i kujdesshëm i të gjitha aspekteve të administrimit të gjykatave, për të përcaktuar se cilat fusha janë më të përshtatshme për gjykatat për t'u menaxhuar dhe cilat duhet të menaxhohen në kuadër të sistemit si tërësi. Disa nga këto përgjegjësi janë të qarta, siç janë përdorimi i TIK-ut në tërë sistemin. Por, disa përgjegjësi të tjera, siç është buxhetimi dhe blerja, do të duhet të jenë të përbashkëta edhe për gjykatat, edhe për Sekretariatit. Megjithatë, qëllimi do të jetë që çdo gjykatë themelore të bëhet sa më autonome që të jetë e mundur, duke e vënë përgjegjësinë për menaxhim dhe aftësinë për të marrë vendime të rëndësishme në nivel lokal.

Objektivi strategjik 2.6.2

Personeli i gjykatave duhet të trajnohet dhe të pajiset për t'i menaxhuar dhe zbatuar me lehtësi ndryshimet në përgjegjësi.

Për t'i bartur përgjegjësitë në gjykatat themelore, personeli i gjykatave duhet të trajnohet me kujdes dhe në mënyrë të thukët, në mënyrë që t'i marrë përsipër përgjegjësitë për menaxhimin dhe përdorimin e sistemeve, siç janë buxhetimi dhe financat. KGjK-ja duhet të përkujdeset që ky trajnim të kryhet ashtu që përgjegjësitë të barten me sukses.

SHTYLLA III

Shtimi i qasjes në drejtësi dhe në shërbimin për qytetarë

Qasje në drejtësi duhet të kenë të gjithë pjesëtarët nga komunitetet tona të ndryshme. Dallimet fizike, ekonomike, gjuhësore dhe dallimet e tjera mund të përbëjnë barriera për drejtësinë. Duhet të ofrohen informata të kuptueshme dhe shërbime të duhura.

Kosova meriton gjykata që janë të hapura për të gjithë ata që kërkojnë drejtësi.

Qëllimi 3.1

Gjyqësori do t'i inkurajojë komunitetet pakicë që të jenë pjesë e sistemit gjyqësor.

Objektivi strategjik 3.1.1

Sistemi gjyqësor do t'i shtojë aktivitetet e kontaktimit me grupet minoritare dhe do ta shtojë qasjen e pakicave në gjykata.

Kosova është shoqëri shumë-gjuhësore dhe shumetnike, fakt ky që është pranuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. KGJK-ja dhe gjykatat individuale duhet të jenë përherë të vetëdijshme për këtë fakt dhe të përpiqen vazhdimisht që të sigurojnë që grupet e pakicave të kenë qasje të plotë në gjykata. Kjo do të marrë formën e të siguruarit që në gjykata të ketë përkthyes të shkathtë dhe adekuatë, monitorim dhe raportim për pjesëmarrjen e pakicave në personelin e administratës gjyqësore, tryeza të rumbullakëta lokale dhe dialog me komunitetet e pakicave të sponsorizuar nga gjykatat.

Objektivi strategjik 3.1.2

Gjyqësori do të angazhohet që ta përmbushë obligimin kushtetues të tij për të emëruar gjyqtarë nga pakicat.

Sistemi gjyqësor ka një detyrim kushtetues për të angazhuar në sistem gjyqtarë nga pakicat. Kjo do të jetë e mundur vetëm me një plan të bazuar në të dhëna statistikore të sakta për rekrutimin aktiv të gjyqtarëve nga pakicat. Edhe stafit në nivel të Sekretariatit do t'i duhet ta monitorojë përparimin dhe t'i zbatojë planet. KGJK do të themelojë një komision që do të merret me çështjen e përfshirjes së më shumë gjyqtarëve dhe stafit administrativ minoritar në sistemin gjyqësor.

Qëllimi 3.2

Gjyqësori i Kosovës do të sigurojë që publiku të ketë qasje në dokumente dhe të dhëna të gjykatave që janë të besueshme dhe që ofrohen me kohë

Objektivi strategjik 3.2.1

Raportet dhe evidencat që bazohen në të dhënat e gjykatave që janë në dispozicion të SKGJK-së duhet të jenë të besueshme, ndërsa publiku të ketë qasje në to.

Besimi i publikut dhe vendimmarrja e brendshme profesionale mbështeten në të dhënat e sakta për sistemin gjyqësor. Të dhënat do të mbeten të sakta nëse përpunohet baza ekzistuese e të dhënave. Për këtë proces do të kërkohet staf i trajnuar plotësisht në nivel të gjykatave dhe të Sekretariatit dhe monitorim dhe testim rutinor i të dhënave. Të dhënat e sakta janë kyçe për marrjen e vendimeve, si në nivel të gjykatave, ashtu edhe në nivel të Sekretariatit. Të dhënat do

të vihen në dispozicion të publikut në ueb portalin e ri, sipas kërkesës që u bëhet subjekteve përkatëse brenda sistemit.

Objektivi strategjik 3.2.2

Gjersa e përmbush përgjegjësinë e tij për ta shtuar qasjen në vendimet dhe informatat e tjera që kanë të bëjnë me lëndët, gjyqësori do t'i ruajë informatat që mbrohen sipas ligjeve të Kosovës për privatësinë.

Kosova siguron që informatat private dhe informatat për grupet e cenueshme të mbrohen. Përderisa sistemi gjyqësor bëhet më transparent dhe i publikon vendimet gjyqësore, ai duhet të sigurojë që të mos shpalosen informatat e mbrojtura individuale. Një protokoll, i cili do të miratohet në një akt nënligjor, do të hartohet për t'u siguruar që procedura për publikimin e informatave të mos i vë në rrezik të dhënat private. Broshura dhe informata të tjera do të përgatiten për ta këshilluar publikun dhe mediat se çfarë mund të merret nga sistemi gjyqësor dhe çfarë duhet të mbetet e mbrojtur sipas ligjit. Monitorim agresiv i procedurave të publikimit do të kërkohej sipas këtij protokollit.

Objektivi strategjik 3.2.3

Faqja ekzistuese e internetit e KGjK-së do të zëvendësohet me një ueb portal gjyqësor, i cili do të azhurnohet vazhdimisht dhe do të përmbajë informata të rëndësishme nga KGjK-ja si dhe informata specifike për gjykatat individuale.

Tashmë ka filluar puna në krijimin e një ueb portali gjyqësor. Ky portal do ta zëvendësojë ueb faqen aktuale të KGjK-së dhe do të përmbajë informata nga KGjK-ja dhe nga çdo gjykatë në kuadër të sistemit. Për shembull, kalendarët e gjykatave individualë do të jenë në secilën faqe të gjykatave. Me rëndësi kyçe për suksesin e këtij sistemi do të jetë që informatat në këtë ueb portal të postohen me kohë, të jenë të sakta, të jenë të lehta për të pasur qasje në to dhe të azhurnohen sa më shpesh që të jetë e mundur.

Objektivi strategjik 3.2.4

Vendimet gjyqësore do të publikohen në ueb portal me kohë dhe sipas të gjitha ligjeve relevante.

Vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit, fillimisht, dhe vendimet e të gjitha gjykatave, eventualisht, do të jenë në dispozicion në këtë ueb portal. Çështjet siç janë redaktimi për t'i mbrojtur të dhënat private dhe opsionet e kërimit do të trajtohen gjatë hartimit të protokolleve dhe dizajnit të ueb faqes.

Qëllimi 3.3

Gjyqësori do ta nxisë besimin dhe mbështetjen e publikut në gjykata përmes komunikimit publik.

Objektivi strategjik 3.3.1

Gjyqësori duhet të bëhet më inovativ në gjetjen e mënyrave për të bashkëvepruar pozitivisht me publikun.

Besimi i publikut në gjyqësor do të shtohet përmes bashkëveprimit pozitiv midis gjykatave dhe publikut. Secila gjykatë themelore do të jetë përgjegjëse për hartimin e programeve në lokalitetet e tyre, siç janë ditët e gjykatës së hapur, takimet me kryetarët e gjykatave, vizitat e rregullta të studentëve, rrjetëzimi potencial social dhe qasjet e tjera inovative. Zyrat për informim publik do ta luajnë një rol kyç në zbatimin e këtyre programeve. Strategjia e komunikimit për gjyqësorin që do të aprovohet nga Këshilli gjithashtu do të adresojë këto çështje.

Objektivi strategjik 3.3.2

Monitorimi i gjykatave, procedurat dhe proceset gjyqësore duhet të jenë të hapura për më shumë vëzhgues.

Disa organizatave të shoqërisë civile u është caktuar për detyrë që t'i monitorojnë procedurat gjyqësore në mbarë Kosovën. Megjithatë, shumë shpesh, disa organizatave u ofrohet qasje në gjykata duke i përjashtuar organizatat e tjera. KGjK-ja do të miratojë një akt nënligjor për të paraparë procedura për dhënien e privilegjeve të monitorimit mbi një bazë që është e drejtë për të gjithë ata që janë të ngarkuar me monitorim.

Qëllimi 3.4

Të përcaktohen tregues të matshëm të performancës për gjykata.

Objektivi strategjik 3.4.1

KGjK-ja dhe kryetarët e gjykatave duhet ta përdorin teknologjinë moderne për të përcaktuar tregues objektivë dhe të matshëm të performancës dhe për t'i ngritur standardet e efikasitetit të gjykatave dhe ato profesionale

Përderisa sistemi gjyqësor do ta përpunojë bazën e të dhënave të tij dhe do ta shtojë aftësinë e tij për t'i analizuar të dhënat, do të jetë e mundur që të përcaktohen norma reale për trajtimin e lëndëve. Përderisa sistemi i ri gjyqësor do të përqendrohet në menaxherët do të jenë në gjendje të përcaktojnë standarde objektive për vlerësimin e performancës së personelit administrativ. Nëpërmjet akteve nënligjore, KGjK-ja do t'i institucionalizojë këto norma dhe do të hartojë procedura për vlerësim të rregullt, qëllimi i të cilave do të jetë që të vërtetohet nëse normat dhe standardet po plotësohen dhe që të korrigjohen sjelljet, në rast se ato nuk plotësohen.

SHTYLLA IV

Promovimi i kompetencës, profesionalizmit dhe mirësjelljes

Administrimi efektiv i drejtësisë varet nga respekti për gjykatat si institucion, si dhe nga kompetenca, profesionalizmi dhe mirësjellja e atyre që punojnë për gjyqësorin apo që kryejnë punë për të. I tërë personeli brenda gjyqësorit dhe qytetaria e Kosovës kanë të drejtë në sjellje me respekt dhe profesionale nga të gjithë pjesëmarrësit e gjykatës. Gjyqtarët dhe personeli i gjykatave duhet të jenë të trajnuar mirë dhe ta kenë mbështetjen e nevojshme për ta arritur përsosmërinë dhe për t'i plotësuar nevojat e publikut.

Qëllimi 4.1

Arsimimi i shtuar dhe trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit të gjykatave.

Objektivi strategjik 4.1.1

SKGjK-ja duhet të hartojë një program të unifikuar dhe gjithëpërfshirës të vlerësimit dhe trajnimit për kryetarët e gjykatave, gjyqtarët mbikëqyrës, stafin administrativ dhe stafin e SKGjK-së për t'i shtuar aftësitë e administrimit dhe menaxhimit të gjykatave

Administrimi i gjykatave duhet të shihet si një profesion me shumë kompetenca. Prandaj, trajnimi për personelin administrativ duhet të jetë gjithëpërfshirës, në mënyrë që çdonjëri ta kuptojë se si puna e tij ose saj ndërlidhet me tërë sistemin. Trajnimi i personelit administrativ të gjykatave do të fillojë duke përdorur këtë model të ri, me module për kërkesat e ndryshme për shkathtësi, siç është menaxhimi i lëndëve, por gjithmonë do të mësohet ashtu që një shkathtësi e veçantë të ndërlidhet me të gjitha shkathtësitë e tjera në gjykatë.

Objektivi strategjik 4.1.2

Gjyqtarët duhet të marrin pjesë në trajnimet e caktuara për individë.

Përderisa sistemi gjyqësor piqet, trajnimi i gjyqtarëve duhet të orientohet më shumë kah gjyqtarët individualë, në mënyrë që secilit gjyqtar t'i ofrohen trajnime shtesë për të cilat ai ose ajo ka nevojë. Për këtë do të kërkohet një proces më i kujdesshëm i vlerësimit, i cili do të parashihet me një akt nënligjor dhe për të cilin do të kërkohet pjesëmarrja e secilit gjyqtar dhe kryetar të gjykatës së tij apo të saj dhe i cili duhet të zhvillohet në bashkëpunim me IGjK-në ose me pasardhësin e tij, në mënyrë që programe të trajnimit individual të hartohen për çdo gjyqtar.

Objektivi strategjik 4.1.3

Gjyqtarët duhet t'i shtojnë shkathtësitë e tyre në arsyetimin dhe shkrimin ligjor për t'u bërë vendimmarrës dhe vendimshkrues më të mirë.

Gjithnjë e më shumë, vëzhguesit e jashtëm e përmendin mungesën e shkathtësive të të arsyetuarit dhe të shkruarit ligjor si të metën më të madhe që duhet të korrigjohet në radhët e gjyqtarëve. Modulet e trajnimit për gjyqtarët e sapoemëruar do t'i kenë për cak këto shkathtësi dhe në mesin e gjyqtarëve, me ndihmën e kryetarëve të gjykatave dhe vlerësuesve gjyqësorë nga KGjK-ja, do të identifikohen ata që kanë nevojë për trajnim korrektues dhe atyre do t'u ofrohet trajnim i duhur.

Objektivi strategjik 4.1.4

Gjyqtarëve dhe stafit administrativ duhet t'u ofrohen më shumë trajnime për teknologjinë informative.

Me nismat e reja për TIK do të vlerësohen shkathtësitë e personelit të gjykatave dhe të gjyqtarëve në përdorimin e teknologjisë informative, ndërsa module përkatëse të trajnimit do t'i ofrohen tërë personelit të gjykatave deri në nivelin e nevojshëm për t'i menaxhuar gjykatat duke përdorur teknologjinë informative.

Objektivi strategjik 4.1.5

Duhet të inkurajohen procedurat jo gjyqësore për ta reduktuar ngarkesën në punë të gjykatave.

Për ta parandaluar grumbullimin e lëndëve dhe për t'u siguruar që gjykatat të jenë përherë efikase, do të inkurajohen procedura jo gjyqësore. Administratorëve të gjykatave dhe gjyqtarëve do t'u ofrohet trajnim për t'i kuptuar metodat jo gjyqësore për zgjidhjen e kontesteve, siç është ndërmjetësimi, dhe për të ditur se kur duhet t'i inkurajojnë apo t'i urdhërojnë palët ndërgjyqësore që të hyjnë në ndërmjetësim.

Objektivi strategjik 4.1.6

Brenda gjyqësorit duhet të ekzistojnë shtigje të qarta të karrierës.

KGjK-ja ka një obligim ndaj qytetarëve të Kosovës që të sigurojë që vetëm anëtarët më të aftë dhe më të kualifikuar të gjyqësorit t'i zënë pozitat në Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit. Për këtë qëllim, një proces transparent dhe i paanshëm do të zhvillohet përmes akteve nënligjore, për të siguruar që këto pozita të plotësohen duke u bazuar në meritat dhe në kriteret e tjera të obligueshme me ligj. Nënprodukt i nevojshëm dhe i dobishëm i këtij procesi do të jetë një shteg i qartë i karrierës, përmes së cilit gjyqtarët mund të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë për t'u ngritur në nivele më të larta të gjyqësorit. KGjK-ja do të ofrojë udhëzime për përpilimin e moduleve të trajnimit për gjyqtarët më të rinj, në mënyrë që ata të mund t'i përvetësojnë shkathtësitë e nevojshme për t'u avancuar në nivele më të larta të gjyqësorit.

SHTYLLA V

Përmirësimi i objekteve dhe teknologjisë së gjykatave

Për administrimin efektiv të drejtësisë kërkohet një mjedis i përshtatshëm fizik dhe teknologjik. Personeli i gjykatave dhe publiku meritojnë objekte që janë të sigurta, të rehatshme, të siguruara dhe funksionale dhe që i plotësojnë nevojat e atyre që i përdorin ato. Teknologjia duhet ta mbështesë përmbushjen e misionit të Gjyqësorit të Kosovës.

Qëllimi 5.1

Sistemet e reja të teknologjisë dhe informimit.

Objektivi strategjik 5.1.1

Përdorimi i teknologjisë duhet të shtohet në gjyqësor dhe të përdoret për t'i përmirësuar marrëdhëniet midis gjykatave dhe SKGJK-së.

Për të arritur efikasitetin, të gjithë pjesëmarrësit duhet të jenë të zgjuar në teknologji. Do të bëhet vlerësimi i nevojave, ndërsa do të hartohen dhe zbatohen plan-programe të duhura për trajnim. Do të ketë mundësi për internet, intranet dhe postë elektronike në tërë sistemin gjyqësor. Plani strategjik i KGJK-së për TIK përfshihet me këtë referencë.

Qëllimi 5.2

Avancimi i objekteve të gjykatës.

Objektivi strategjik 5.2.1

Objektet e reja të Gjykatës Themelore duhet të jenë në përputhje me standardet e BE-së dhe ato evropiane për kushtet e punës dhe ta promovojnë procedimin efikas dhe efektiv të lëndëve.

KGJK-ja ka konstatuar se nevojiten pesë ndërtesa të reja të gjykatave. Secila duhet të disenjohet sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe standardeve të BE-së. Do të angazhohen ekspertë nga Sekretariati për t'i vlerësuar kushtet ekzistuese të punës dhe për ta garantuar zbatimin e standardeve ndërkombëtare. Në plane do të dizajnohen më shumë salla të gjykimit me ulëse adekuate për publik.

Qëllimi 5.3

Siguria e shtuar për gjyqtarët, personelin e gjykatave, publikun dhe objektet e gjykatave.

Objektivi strategjik 5.3.1

Sigurimi fizik i të gjitha objekteve dhe personelit të gjykatave, gjyqtarëve dhe familjeve të tyre duhet të shtohet.

I domosdoshëm për një gjyqësor të pavarur është sigurimi fizik edhe nga shkaqet e krijuara nga njeriu, edhe nga ato natyrore. KGJK-ja do ta miratojë një akt nënligjor, i cili ta përcaktojë rolin dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të sigurisë në gjykata dhe do të mbajë trajnime fillestare dhe të vazhdueshme për personelin e sigurisë dhe personelin administrativ. Memorandume do të lidhen me komandat e duhura të policisë.

ZBATIMI DHE MONITORIMI I PLANIT STRATEGJIK

KGJK do të krijojë dhe plotësojë një pozitë brenda Sekretariatit me kompetencë për të monitoruar përparimin drejt qëllimeve strategjike dhe do të zhvillojë një protokoll për raportim.

KGJK do të përdorë tabelën në shtojcën 2 për të hartuar plane më të hollësishme të punës për arritjen e çdo qëllimi strategjik dhe objektivë të mbështetur në udhëzimin që do të aprovohet nga Këshilli.

SHTOJCA 1 - KOMISIONI PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK

1. Enver Peci, Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës
2. Albert Avdiu, Drejtor, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Grupi Punues i Vogël)
3. Salih Mekaj, Kryetar i Gjykatës së Apelit dhe anëtar i Këshillit,
4. Gerrit-Marc Sprenger, gjyqtar i EULEX-it dhe anëtar i Këshillit
5. Bashkim Hyseni, Kryetar i Gjykatës, Gjykata Themelore e Ferizajt (Grupi Punues i Vogël)
6. Avdirrahman Gashi, gjyqtar mbikëqyrës, Dega e Gjykatës në Lipjan, Gjykata Themelore e Prishtinës
7. Sherif Krasniqi, Bashkëpunëtor Profesional, Gjykata Supreme
8. Isak Shala, Referent për Çështje Penale, Gjykata Themelore e Prishtinës
9. Muhamet Asanaj, Administrator i Gjykatës, Gjykata Themelore e Pejës
10. Arbër Jashari, Zyrtar për Informim Publik, Gjykata e Apelit (Grupi Punues i Vogël)
11. Petrit Kryeziu, përfaqësues i BIRN-it
12. Adem Gashi, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Kosovar për Drejtësi (Grupi Punues i Vogël)
13. Lumnije Krasniqi, Koorditore e Programit, Instituti Gjyqësor i Kosovës
14. Astrit Dibra, Ndihmës-administrator, Dega e Gjykatës në Skenderaj, Gjykata Themelore e Mitrovicës
15. Fatmir Rexhepi, Shef i TIK-së, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Grupi Punues i Vogël)
16. Besnik Ramosaj, Shef i Statistikave, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Grupi Punues i Vogël)

SHTOJCA 2 - AKTIVITETET, PËRGJEGJËSITË DHE TREGUESIT

	OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	AKTIVITETET	PËRGJEGJËSITË	TREGUESIT
SHTYLLA I. KRIJIMI I BESIMIT DHE MBËSHTETJES				
